UDHËZIM
Nr. 15, datë 12.7.2013

PËR PROCEDURAT E POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LICENCË TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE PLOTËSUESE PRIVATE PARAUNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 15, 16, pika 4, neni 17 pika 3/d dhe neni 20 të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
KËRKESA PËR DHËNIEN E LICENCËS

1. Kërkesa dhe dosja e aplikuesit për licencë, e plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim paraqiten në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) jo më vonë se 3 muaj para fillimit të vitit shkollor për institucionet arsimore dhe gjatë vitit për institucionet arsimore parashkollore dhe ato plotësuese parauniversitare private.

2. Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesës bëhet në përputhje me kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese shoqëruese përkatëse, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.

3. Qendra Kombëtare e Licencimit dërgon në formë elektronike në Drejtorinë për Zhvillimin e Arsimit Jopublik (DZHAJ) në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi. DZHAJ shqyrton paraprakisht dokumentacionin e subjektit (person juridik ose fizik) që aplikon për licencë të institucionit arsimor parauniversitar privat apo të institucionit arsimor plotësues parauniversitar privat. Në rast se gjatë shqyrtimit paraprak, DZHAJ konstaton mangësi në dokumentacion, i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës refuzimin e kërkesës.

4. Dosja e subjektit aplikues duhet të përmbajë dokumentacionin për:

a) Marrëdhënien pronësore (certifikatë pronësie, kontratë qiraje etj.) që subjekti ka për objektin/et dhe mjedisin/et që do të përdoren për shërbimin arsimor;

b) Arsimimin dhe kualifikimin sipas akteve ligjore dhe nënligjore të drejtuesit didaktik dhe personelit mësimdhënës;

c) Kontratën e punës me kohë të plotë mes subjektit kërkues dhe drejtuesit didaktik;

d) Rregulloren e brendshme të institucionit, të detajuar, në të cilën, ndër të tjera, të përcaktohet:

d.1 Lloji dhe niveli i arsimimit që do të ofrojë numrin e grupeve apo të klasave që do të formohen, numrin maksimal të fëmijëve/nxënësve për grup/klasë dhe, për shkollat, titullin e dokumentit që do të lëshohet në përfundim të çdo viti shkollor, ciklit apo kursit të arsimimit.

d.2 Emërtimi i institucionit, numrin e telefonit personal të administratorit dhe të institucionit, adresën e institucionit dhe të postës elektronike.

d.3 Deklaratë dhe listë e detajuar për shërbimet që do të ofrohen në këtë institucion.

d.4 Tarifat përkatëse dhe modalitetet e pagesave që do të kontraktohen me përfituesit e shërbimit.

e) Deklaratë nga subjekti për zbatimin e kurrikulës zyrtare (plane mësimore, programe lëndore dhe tekste mësimore) të miratuara nga MASH-i.

f) Listë të plotë të stafit drejtues, mësimdhënës dhe të dhënat mbi arsimimin përkatës të stafit, si

dhe ngarkesën mësimore të tij.

g) Deklaratë për inventarin faktik të bazës materiale dhe asaj didaktike që mendohet të vihet në dispozicion dhe që është në funksion të arsimimit, edukimit dhe realizimit të kërkesave të programeve lëndore (për të provuar se mjetet mësimore janë të mjaftueshme për të realizuar kërkesat e planit mësimor dhe të programeve lëndore).

5. Standardet normative që duhet të përmbushë/in objekti/et që do të funksionojë/në si institucion/e arsimore private janë:

a) Klasë e zakonshme konsiderohet ai mjedis mësimor që ka një normativë sipërfaqeje shfrytëzimi prej 1.3-1.6 m²/nxënës;

b) Nyjat hidrosanitare përfshijnë 1 boks për 40 djem, 1 boks për 30 vajza, si dhe 1 boks për administratën.

c) Për kopshtet, shërbimet higjienike vendosen pranë çdo grupi dhe pozicionohen në mënyrë të tillë që të jenë sa më afër për secilin grup. Numri i bokseve duhet të jetë 3 (tri) për një grup, të ndarë me mure nga njëri-tjetri, si dhe duhet të ketë dhe katër lavamanë me ujë të pijshëm. Banjat duhet të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja. Pajisjet e banjave duhet të jenë të përshtatshme për moshën e fëmijëve.

d) Për edukimin fizik, subjekti që kërkon licencë duhet të ketë në dispozicion një palestër sportive (për shkollat nën 100 nxënës shfrytëzohet një klasë në katin përdhe me përmasa 60 m²) dhe një kënd sportiv jo më i vogël se 100 m².

e) Objektet arsimore që vihen në dispozicion për nivele të ndryshme arsimimi (kopshte, shkollë 9-vjeçare dhe shkollë e mesme) të kenë mjedise që nuk komunikojnë me njëri-tjetrin.

f) Lidhur me normativën e ndriçimit natyral duhet që sipërfaqja e dritareve të mbulojë minimalisht 15% të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi duhet të jetë në krahun e majtë të nxënësit, mundësisht i orientuar nga juglindja. Ndriçimi të realizohet me dritare me xham të tejdukshëm. Dritaret nuk lejohet të vendosen në murin ku është vendosur dërrasa e zezë.

g) Për shkollat e arsimit bazë (sistemi 9-vjeçar) duhet të jenë në dispozicion, minimumi 9 klasa për ciklin e ulët dhe të lartë dhe dy dhoma mësuesish. Për shkollat e ciklit të ulët (6-vjeçar) duhet të jenë në dispozicion, minimumi 6 klasa dhe një dhomë mësuesish. Për shkollat e mesme të përgjithshme/profesionale duhet të jenë në dispozicion, minimumi, 5 dhoma mësimore. Për kopshtet të ketë minimalisht 3 dhoma mësimore.

h) Objektet arsimore me mbi 200 nxënës duhet të jenë të pajisura me dalje dhe shkallë emergjence.

i) Objektet arsimore duhet të jenë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë dhe pajisjet e nevojshme në të.

j) Objektet arsimore duhet të kenë sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.

k) Objektet arsimore të jenë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore dhe të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për nxënësit, duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Materialet e përdorura për ndërtimin e tyre nuk duhet të kenë elemente përbërëse të dëmshme për shëndetin e nxënësve. Këto materiale duhet të sigurojnë akustikë të mirë në mjedisin e mësimit dhe të jenë izoluese ndaj zhurmave dhe luhatjeve të temperaturës.

l) Objektet arsimore duhet të jenë larg zonave industriale, varrezave apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara.

m) Objektet arsimore të kenë sistem ngrohjeje dhe burime alternative për furnizimin me ujë dhe energji elektrike.

6. Verifikimi i përmbushjes së standardeve normative të infrastrukturës të objektit shkollor kryhet me nismën e Drejtorisë për Zhvillimin e Arsimit Jopublik (DZHAJ) nga personeli i kualifikuar i njësisë arsimore vendore (NJAV) në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e subjektit. NJAV përgatit një raport vlerësimi shoqëruar me rekomandime për miratimin apo jo të licencës.

7. DZHAJ, pasi vlerëson rregullsinë e dokumentacionit dhe përputhshmërinë e planit mësimor, programeve lëndore dhe teksteve mësimore që do të zbatojë institucioni, me ato të miratuara, vendos miratimin ose refuzimin e kërkesës për licencë.

7.1 Vendimi miratues ose refuzues i MASH-it i dërgohet QKL-së në formë elektronike dhe shkresore. Për rastet kur kërkesa e subjektit nuk miratohet, vendimi refuzues duhet të përcaktojë qartë shkaqet e refuzimit, të shprehura në mënyrë të tillë që kërkuesi të kuptojë se ç'masa duhet të marrë që, me një aplikim të dytë, të mund të pajiset me licencën e kërkuar.

7.2 Vendimi i miratimit apo refuzimit, që i përcillet QKL-së, publikohet në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, sipas procedurave dhe afateve ligjore të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar".

8. Mosdërgimi i vendimit brenda afatit (2 javë), vlerësohet si miratim në heshtje, përveç rastit kur, para mbarimit të këtij afati, DZHAJ kërkon në regjistrin aplikativ, shtyrje afati për rastin përkatës. Shtyrja e pashpallur në regjistrin aplikativ është e pavlefshme. Kërkesa për shtyrje të afatit sqaron domosdoshmërish edhe shkaqet objektive të pamundësisë për shqyrtimin e kërkesës që e kanë diktuar atë. Shtyrja mund të përdoret vetëm një herë dhe ajo nuk mund të jetë më e gjatë se vetë afati përkatës i marrjes së vendimit.

9. Institucioni arsimor e ndërpret veprimtarinë e tij arsimore vetëm në fund të vitit shkollor.

10. Pas procedurave të revokimit të veprimtarisë së tij pranë QKL-së, institucioni duhet të lajmërojë menjëherë Njësinë Arsimore Vendore (NJAV) dhe të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e plotë në NJAV.

KREU II
TARIFAT E SHËRBIMIT

1. Institucionet arsimore private parauniversitare dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare licencohen përkundrejt tarifave të përcaktuara si më poshtë:

Nr.	**Institucionet**	**Tarifa në lekë**
1	Për kopsht	35.000 (tridhjetë e pesë mijë)
2	Për shkollë të ciklit të ulët fillor	45.000 (dyzet e pesë mijë)
3	Për shkollë të ciklit të lartë 9-vjeçar	45.000 (dyzet e pesë mijë)
4	Për shkollë 9-vjeçare	55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë)
5	Për shkollë të mesme të përgjithshme	70.000 (shtatëdhjetë mijë)
6	Për shkollë të mesme teknike-profesionale e social-kulturore	60.000 (gjashtëdhjetë mijë)
7	Për kurs plotësues (IAPPRP)	70.000 (shtatëdhjetë mijë)

KREU III
DETYRIMET E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR DHE INSTITUCIONIT ARSIMOR PLOTËSUES PRIVAT PARAUNIVERSITAR

1. Një institucion arsimor parauniversitar privat apo institucion arsimor plotësues parauniversitar privat me fillimin dhe gjatë veprimtarisë së tij duhet të raportojë në NJAV sipas afateve të përcaktuara prej saj:

- numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve që do të fillojnë dhe mbarojnë vitin shkollor sipas udhëzimeve të MASH-it dhe statistikave tip të miratuara nga INSTAT-i;
- planin mësimor, programet lëndore dhe strukturën që do të ketë institucioni në fillim të çdo viti shkollor;
- certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;
- listën e veprimtarive jashtëshkollore që janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit shkollor (për institucionin arsimor privat parauniversitar).

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat duhet të miratojë në MASH çdo ndryshim në planin mësimor, programet lëndore apo tekstet që do të përdorë institucioni dhe çdo projekt apo eksperimentim

psiko-pedagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë sipas rastit.

3. Ndryshimet në vendndodhje dhe në infrastrukturën e godinës që mund të pësojë institucioni arsimor privat i licencuar, shqyrtohen dhe miratohen nga QKL-ja, pas miratimit të Drejtorisë për Zhvillimin e Arsimit Jopublik (DZHAJ), 3 muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës.

4. Një institucion arsimor privat parauniversitar apo institucion arsimor plotësues privat parauniversitar duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të nxënësve dhe të mësuesve;

b) regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase, evidencë për lëvizjen e nxënësve (i detyrueshëm për institucionin arsimor privat parauniversitar), planet mësimore dhe programet lëndore të zbatuara çdo vit shkollor;

c) rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit;

d) kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve;

e) kontratat me prindërit për shërbimet arsimore apo shërbime të tjera jashtëshkollore që ofron;

f) kontratat e punës me mësuesit (për ata me kohë të plotë apo të pjesshme).

Ky dokumentacion, në rast inspektimi e monitorimi të veprimtarisë së institucionit, duhet t'u vihet në dispozicion organeve kompetente mbikëqyrëse.

5. Institucionet arsimore private, të cilat funksionojnë sipas kritereve të përcaktuara me këtë udhëzim, veprojnë në përputhje me detyrimet e institucioneve arsimore dhe dispozitat normative që rrjedhin nga ligji nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

6. Në rast të revokimit të veprimtarisë së tij nga QKL-ja, institucioni duhet të lajmërojë menjëherë Njësinë Arsimore Vendore (NJAV) dhe të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e plotë në NJAV.

7. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e informacioneve nga organet kompetente mbikëqyrëse dhe inspektuese, të cilat do të verifikojnë apo kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre institucioneve arsimore, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 33, datë 1.11.2010 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare", shfuqizohet.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Jopublik, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme (sektori juridik) dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCAVE
Myqerem Tafaj